

FITËR BAJRAMI, SHESHI I FUSHË ÇELËS, DËSHMITAR I LAVDISË SË BESIMIT

“Përtej propagandave të stisura, ku ditë pas dite sulmohet Islami dhe muslimanët, besimtarët duhet të ndjehen përherë e më shumë krenarë me fenë e tyre islame, që është burim dijeje, qytetërimi, përkushtimi dhe humanizmi në këtë botë.”



MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1436/2015

Të dashur dhe të nderuar, motra dhe vëllezër muslimanë,

Të dashur bashkëqytetarë të Shkodrës,

Edhe pak orë na ndajnë nga iftari i fundit i këtij Muaji të begatë, në të cilin përjetuam mrekulli të shumta të besimit dhe gjendjes së afrimit me Zotin e gjithësisë, nëpërmjet agjërimit me bindje dhe përkushtim, adhurimeve të ditës e të natës, pesë namazeve ditore, 20 rekateve të përnatshme të teravisë, Hatmes Sherife të Kur'anit Famëlartë, sadekave dhe zekatit, sofrave kuptimplota të iftarit me shtresat e ndryshme të shoqërisë, lutjet dhe përgjërimet e Natës së Kadrit etj.

Kushdo që ka shpresuar në faljen dhe mëshirën e Tij, e ka pasur mundësinë ta gjejë atë dhe ta fitojë, në këtë periudhë njëmuajore, të mbushur me begati hyjnore për shpirtin dhe jetën e secilit prej nesh!

Ky Fitër Bajram, si një festë madhore e mbarë ymnetit islam, i gjen muslimanët e mbarë botës në krahët e sprovave të mëdha jetike, fetare, politike, identitare, kulturore, ekonomike, komunitare e përtej tyre.

Ky Fitër Bajram, me mesazhet e mrekullueshme të fituara gjatë Muajit Ramazan, është një ftesë hyjnore dhe një tërheqje vëmendjeje për të shikuar më me përparësi në thelbin e fesë islame në shoqëritë tona.

Është një ftesë, që çdo musliman të meditojë në mirësitë e fesë së tij dhe të bëjë disa krahasime me propagandën thujtë të përditshme, që bën rolin e zhurmuesit, për ta prezantuar fenë e tij si koka e të keqes globale!?

A është vallë Islami ynë nxitës i shkatërrimit, dhunës, shkeljes flagrante të drejtave elementare

të njeriut, frikësues i popujve dhe terrorizues i tyre, siç, një grup i caktuar njerëzish me maskë mashtruese, mundohet ta prezantojë sot Islamin, në rolin e misionarit të suksesshëm të mashtrimit dhe terrorizimit të krejt globit?!

A mund të jetë dhuna, terrori, frika, kërcënimi, përbaltosja e vlerave të tjetrit, vrasja me gjakftohtësi, dhunimi i objekteve të kultit joislam dhe tmerrimi i jomuslimanëve, identiteti i pasuesve të Kur'anit, që nxit: "Njerëzve t'u flisni mirë", "Dhe veproni të mirën", "Hyni të gjithë në hapësirat e paqes", "Mos polemizoni me pasuesit e Librit, vetëm se me atë që është më e mira" etj?

A mund të jetë kërcënimi i tjetrit me jetë, vrasja e të pafajshëmve, dhunimi i grave, fëmijëve, gjurmëve të dijes e të kulturës, identiteti i atyre, që pasojnë Hz. Muhammedin (a.s), që thoshte: "Unë jam njeriu më i afërt me Isain, birin e Merjemit", "Musliman është ai, prej dorës dhe gjuhës së të cilit, muslimanët janë të shpëtuar", "Krejt krijesat janë robë të All-llahut. Më i dashuri i tyre për All-llahun është më i dobishmi i tyre për robët e Tij". U ngrit në këmbë përpara xhenazës së një të vdekuri dhe, kur i thanë se ishte hebre, u përgjigj: "A nuk është njeri?!"

"Shkoni se jeni të falur", - u tha mekasve jomuslimanë, që e lënduan pa masë, ditën e çlirimit të saj.

"Unë shpresoj që nga mesi i tyre të dalin besimtarë...", - ishte përgjigjja e tij, atë ditë kur i lënduar dhe i gjakosur nga femohuesit e qytetit Taif, i përgjigjej melekëve që kishin ardhur ta shkatërronin atë popull!

Fitër Bajrami i këtij viti, në këto kontekste historike globale, merr një dimension edhe më të rëndësishëm, teksa bëhet një thirrës i sinqertë drejt vlerave të vërteta islame; afrimin e muslimanëve me njëri-tjetrin mbi baza dijeje, harmonie,

vëllazërimi ndërtues, bashkëpunimi në të mirë të komunitetit dhe të vetë shoqërisë.

Është folur këto ditë për frikën e radikalizmit islam në botë. Shumëkush me naivitet a jo, ka rënë pre e këtij mashtrimi global, në emër të Islamit. Shumëkush është ngritur për të zhvilluar konferenca, takime, seminare. Shumë mirë kanë bërë. Edhe më shumë konferenca të tilla të zhvillojnë, sepse nëpërmjet arsytimit dituror, argumenteve burimore dhe leximeve bashkëkohore, do të vërtetohet se një fé, që në thelb të emrit të saj ka paqen dhe ndërtimin e urave të komunikimit të shëndoshë njerëzor, dialogun dhe pranimin e tjetrit, nuk mund të jetë burim terrori, dhune dhe shkatërrimi.

Diellit nuk mund t'i thuash burim vetimash dhe gjëmimesh, se ca re të zeza kalimtare i kanë zënë dritën dhe madhësitinë e tij dhe hiqen si rrezatim lartësishë.

Kështu po ndodh edhe me Islamin, sot në mbarë botën!

Fitër Bajrami është ditë gëzimi, ditë adhurimi, ditë faljeje, ditë vizitash dhe takimesh, në të cilat, kemi përherë mundësinë e madhe për t'u dëshmuar muslimanë krenarë me fenë tonë; njerëz të pastër e ndërtues, larg injorancës dhe përherë e më shumë më afër të gjithë atyre që e duan paqen dhe vërshojnë drejt saj, qoftë edhe në drejtime, që shpesh na ndajnë në këtë rrugëtim të gjatë njerëzor.

Me zemër të mirë Fitër Bajramin!
Zoti ju bekoftë e ju dashtë!

Imam Muhamed Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 16 korrik 2015

29 Ramazan 1436



Dr. Muhamed Sulejman - Damask

Të vjen keq sot, të ketë disa njerëz në botën islame, të cilët i lëvizin (qarkullojnë) disa të shkuara nga ajo që ka qenë prej historisë së ymetit. I tërheq çdo e vjetër, vetëm se ajo është e vjetër dhe jo për ta rinovuar, apo për ta përshtatur me natyrën e njeriut dhe instinktet e tij drejt kuptimit të gjërave dhe perceptimit të tyre.

Të vjen keq, që ligjërimi jonë fetar vuan krizën e përsëritjes e tonin mbrojtës dhe ngarkimin e përgjegjësisë vetëm tjetrit për prapambetjen, në të cilën kemi arritur dhe rënien e efikasitetit dhe ndikimit tonë.

A nuk ka ardhur koha për ne që të përcaktojmë përparësitë në përballjen me këtë fazë të vështirë, në të cilën po kalon ymeti dhe shoqëria jonë? Dhe, prej kërkesave të saj është leximi i realitetit me një lexim të vetëdijshëm mendor dhe lexim të trashëgimisë e çfarë na kanë lënë pas imamët tanë të mëparshëm me një lexim të ri, për të kuptuar realitetin në formën më të mirë e për të arritur tek ligjërimi islam intelektual thirrës shpirtëror të shpëtuar prej problemeve të realitetit tonë islam, larg nga imitimi i verbër dhe klonimit të historisë e problemeve që janë shfaqur, të cilat kanë pasur kohën dhe vendin e tyre.

Nuk ka dyshim, dhe prej shndërrimit tonë të thellë në transmetues që nuk mendojnë, janë kthyer në lejues të vrasjes së vëllezërve të tyre në fe, të tjerë kapen fort rreth konflikteve mendore, kanë qenë dhe janë bërë e shkuar, shumë janë bërë skllëvër të një mënyre mendimi, që ka udhëhequr, është shuar dhe ka mbaruar. Ajo ka pasur vendin, kohën, kushtet dhe gjendjen e saj, ndërkohë disa janë kthyer në konfliktues, frikësues,

PËRPARËSITË TONA

blasfemues të tjetrit dhe iluzionojnë se çelësat e xhenetit janë në duart e shehave, muridave, ndjekësve dhe pasuesve të tyre dhe u premtojnë kundërshtarëve dhe armiqtë se janë në zjarr.

Të gjitha rrymat e thirrjes kanë nevojë për një interesim më të madh për unitetin e myslimanëve dhe shtim të origjinalitetit, urtësisë së thirrjes dhe ligjërimit të vetëdijshëm, i cili e respekton tjetrin dhe nuk e mohon, apo përjashton atë.

Trashëgimia jonë ka qenë dhe do të ekzistojë, nuk kanë shterur dhe nuk do të mbarojnë qëllimet e saj, por edhe ne nuk kemi përfituar prej saj siç duhet.

A nuk ka ardhur koha për ne, që t'i tejkalojmë propozimet e masave të sjellura rreth temave dytësore pjesore prej adhurimeve nafle (vullnetare), që disa dijetarë u janë përkushtuar dhe mbajnë për to simpoziume e duele, ku për shkak të tyre nxehen gjakrat, pa kujtuar se ekzistojnë përparësi të tjera, më me rëndësi dhe më me nevojë urgjente?

Nuk mundet të ndahet thirrja prej ligjërimit të thirrjes, për këtë patjetër duhet kthim në ripërgatitjen e shumicës me një përgatitje besimore, shkencore, aktuale, intelektuale dhe shpirtërore.

Le të jetë ligjërimi i xhumasë hulumtues i pyetjeve të njerëzve dhe sfidave të kohës, në mënyrë që të mos bërtasim në humnerë dhe le të jenë

Patjetër duhet një përparësi aktuale ndaj asaj historike dhe të mos jetojmë përgjumësi mendore dhe hutim të madh ndaj aktualitetit dhe problematikës sonë madhore...

programet fetare televizive dhe rrjetet lidhëse sociale, të cilat hulumtojnë për të njëjtën gjë, tu përgjigjen nevojave të myslimanit bashkëkohor, kujdesen për mendje pjesëmarrëse dhe ngrejnë lart tabanin e shqetësimeve të tij.

Duhet patjetër ta prezantojmë ligjërimin tonë fetar në origjinalitetin e tij, larg prej shumë zbatimeve historike, të prira për të qenë të gabuara e të sakta, dhe mos justifikimit të gabimit, por madje analizimit të motive dhe prapaskenave të tij, në mënyrë që të mos bëhet ky gabim në emër të ixhtihadit (interpretimit) fe.

Patjetër duhet një përparësi aktuale ndaj asaj historike dhe të mos jetojmë përgjumësi mendore dhe hutim të madh ndaj aktualitetit dhe problematikës sonë madhore, pyetjeve të asaj që na rrethon, prandaj le t'i kapërcejmë propozimet, shkrimet dhe vaset (ligjëratat), madje edhe disa disertacione universitare, bëjnë të ndihesh sikur shkruesi, apo lexuesi i tyre jeton në kohën e vjetër, jo në kohën tonë dhe beson sikur ai nuk ka asnjë lidhje me kohën, as problemet e tij problemet tona, as mendimi i tij me mendimin tonë dhe as njohuritë e tij me njohuritë tona.

Nuk është e metë të ndryshojmë në renditjen e përparësive dhe të ketë çdo njeri, apo çdo metodë përparësitë e tij, të cilat ndryshojnë prej njëri-tjetrit, por e metë është të rend secili prej nesh në shembjen, eliminimin, zhvleftësimin dhe shkatërrimin e punës së tjetrit, metodës dhe thirrjes së tij, çfarë na bën të hyjmë në betejat e shkatërrimit, në vend të betejave të ndërtimit, na fusim në përplasje, në vend të përsosjes.

Patjetër duhet një ekuilibër mes interesave dhe dëmeve, madje edhe ekuilibër mes të mirës së dy të mirave, të keqes së dy të këqijave, për t'ia kthyer njeriut mirëbesimin në fenë e tij, në mënyrë që të mos bie në grackat e shpresës dhe të dilemës, e të kërkojë strehim në mendimet ekstremiste, apo mendim të fundit që koha i ka dhënë selam qëmoti.

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut, Krijuesit të Vetëm të gjithësisë, i Cili e bëri Natën e Kadrit, shenjë mrekullie, që lidhet me Fjalën e Tij, me Librin e fundit Kur'anin, në të cilin thotë: “Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzojnë se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.”¹

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), i cili thoshte: “Mjerë ai që thotë: Kam harruar këtë ajet a atë ajet! Atij i është fshirë nga kujtesa! Përsëriteni Kur'anin, sepse ai largohet nga gjokset e burrave, më shpejt sesa devetë!”²

TË DASHUR DHE TË NDERUAR VËLLEZËR BESIMTARË,

Tashmë që përshpirtësia e Natës së Kadrit ka nisur të sillet në orbitën e zemrës dhe shpirtit të secilit prej nesh, ajetet kur'anore dhe hadithet e ndryshme profetike, që na nxisin për të ruajtur një marrëdhënie të rregullt dhe të shëndoshë me Kur'anin Famëlartë, janë të shumta.

Gjatë këtyre ditëve, teksa jemi të tubuar në mexhlin e Hatmes Sherife, shpesh, teksa ndalemi dhe komentojmë, analizojmë a shpjegojmë ajete të ndryshme,

1. Kur'ani, El-Isra: 9.

2. Transmetuar nga Muslimi, nga Ibni Mes'udi (r.a).

“A NUK PO NA THOTË SHESHIT SE UNË JAM FJALA E ZOTIT..”!?

që përmbajnë ngjarje, këshilla, urdhëresa, ndalesa etj, më vjen ndër mend paralajmërimi i Resulull-llahut (a.s), që thoshte: “Do të dalin ndër ju ca njerëz, që do të kenë neveri nga namazi i tyre, në krahasim me namazin tuaj, edhe nga agjërimi i tyre, në krahasim me agjërimin tuaj, edhe nga veprat e tyre, në krahasim me veprat tuaja. Ata e lexojnë Kur'anin, por ai nuk e kalon kufirin e fytit të tyre!? Ata dalin nga feja, siç del shigjeta nga preja...”³

Nga këtu, më lejoni të pyes: A e lexojmë ne Kur'anin me meditim dhe me dëshirë për ta përvetësuar shpirtin e tij në jetën tonë të përditshme?

Por, përpara këtij momenti shumë kulminant, a e kemi kapërcyer ne pragun e besimit me bindje se ky Libër është Fjala e mrekullueshme e Zotit të botëve, udhërrëfyes për ne dhe jetën tonë?

A jemi sot në gjendje ta këshillojmë veten tonë me porosinë kur'anore, me të cilën Zoti i gjithësisë i drejtohet të dashurit të Tij, Hz. Muhammedit (a.s): “Përmbaju asaj që po të shpallet, s'ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë. Pa dyshim që Kur'ani është përkujtesë për ty dhe për popullin tënd; e ju do të pyeten!”⁴?

Imam Kurtubiu, teksa e komenton këtë ajet, sqaron sa më poshtë: “Fjala e Zotit: “Përmbaju asaj që po të shpallet”, nënkupton Kur'anin, edhe nëse do ta përgënjeshtrojnë, sepse: “s'ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë!”, që të shpie drejt All-llahut, pëlqimit dhe shpërblimit të Tij!”⁵

TË DASHURIT E MI,

3. Transmetuar nga Muslimi, nga Ebu Said El-Khudriu (r.a).

4. Kur'ani, Ez-Zuhruf: 43-44.

5. Imam Ebu Abdull-llah Muhammed ibn Ahmed El-Ensari El-Kurtubi, “El-Xhamiu li ahkamil-Kur'an”, botimi i dytë, Kajro, 1996, vëll. i 16-të, f. 91.

Ka shumë rëndësi të kuptojmë dhe të vlerësojmë këtë mirësi të madhe, që na është mundësuar sot, falë edhe zhvillimit të teknologjisë; shumimi i botimeve të Kur'anit, përkthimi i kuptimeve të ajeteve të tij në gjuhë të shumta, në mbarë botën, përhapja e komentimeve dhe analizave të detajuara dhe të thelluara të tij etj, që janë një ndihmesë e madhe, shumë e madhe, për të na afruar përherë e më shumë me Fjalën e All-llahut.

*“DO TË DALIN NDËR JU
CA NJERËZ, QË DO TË KENI
NEVERI NGA NAMAZI I TYRE,
NË KRAHASIM
ME NAMAZIN TUAJ,
EDHE NGA AGJËRIMI I TYRE,
NË KRAHASIM
ME AGJËRIMIN TUAJ,
EDHE NGA VEPRAT E TYRE,
NË KRAHASIM
ME VEPRAT TUAJA.
ATA E LEXOJNË KUR'ANIN,
POR AI NUK E KALON
KUFIRIN E FYTIT TË TYRE!?
ATA DALIN NGA FEJA, SIÇ DEL
SHIGJETA NGA PREJA...”*

Teksa flet për faktin se Kur'ani është mrekulli dhe ftesë drejt besimit, Hafiz Ali Korça (1873-1957), në maj të vitit 1925, shkruan: “Kurani i madhënueshëm është nga ato muxhize që le gjer ditën e sotme që vleftën e ka mbajtur, por edhe sa

të jetë jeta ka me e mbajt... Pra, Hazreti Kurani ashtë një muxhize e përherhme, e përgjithëkohëshme dhe e pavdekshme. Si mund të vdesë, kur folës i tij ashtë Zoti i vërtetë, Vetë!

Sa për disa Zotëni që akoma s'dinë pesë fjalë arebisht, qysh mundin të thonë se Kurani është kështu e ashtu?!

Përse ta zgjatim, sanscrita që mban librin e shenjtë Zind (Zend) vdiq, gërqishtja e vjetër vdiq, latinishtja vdiq, ibranishtja vdiq. Edhe shumë gjuhë të tjera që përmbanin nga një libër të shenjtë vdiqnë dhe në vënt të tyne lindën të tjera, por gjuha arebishtë në hije të mirakullisë të H. Kuranit hala rron, edhe sa të jetë bota do të rrojë! Edhe ndaj, populli mysliman do të mbretërojë!⁶

Prandaj, ditë pas dite, ne jemi të ftuar ta bëjmë Kur'anin pikë referimi në jetën tonë, ta lexojmë pa ndërprerje, me një përkushtim të singertë, për të dëshmuar transformimin vetjak dhe atë shoqëror, në gjurmët e Resulull-llahut (a.s). Sepse, angazhimi i vazhdueshëm me Kur'anin jep frutet e veta, që sjellin dobi për njeriun, natyrën, bimësinë, kafshët e gjithësinë.

Dr. Sheuki Ebu Khalil, në librin e tij të famshëm: "Kush e humbi Kur'anin?"⁷, ndër të tjera shkruan:

6. H. ALI, "Muxhize e Hazreti Kuranit", revista "Zani i Naltë", nr. 3, vit' i II, Tiranë, 1925, f. 451-458. (Nga kolana "Zani i Naltë", vëllimi i parë: 1923-1924-1925, botimet KMSH, Tiranë, 2014). (Me përshtatje të lehtë. M.S.)

7. Në arabisht: "Men dajjaal-Kur'an".

[Fruti i parë dhe shembullor i mësimëve të Kur'anit Famëlartë ishte personaliteti i Resulull-llahut (a.s)... S'ka dyshim se ai ishte njeri me sjellje dhe edukatë engjëlllore. Dhe, All-llahu qoftë i kënaqur me nënën e besimtarëve, Zonjën Aishe, e cila, kur u pyet për sjelljen e të dërguarit të All-llahut (a.s), tha: "Sjellja dhe morali i tij ishte Kur'ani, kënaqej me pëlqimin e tij dhe zemërohej me zemërimin e tij"]⁸

Pra, me fjalë të tjera, unë ftoj të rinjtë muslimanë, ta mendojnë me shumë seriozitet idenë e kthimit të Kur'anit në burim udhëzimi dhe gurrë bekimesh hyjnore, që e ndihmojnë për ta jetuar jetën në mënyrë shembullore, duke kërkuar fitimin e pëlqimit hyjnor!

Jo vetëm kaq, por të rinjtë e sotëm muslimanë janë të ftuar ta lexojnë e ta mësojnë Kur'anin, ta shijonë arabishten e tij dhe ta mësojnë me një përparësi ndaj çdo gjuhe tjetër; ajo është gjuha e Fjalës së Zotit, e Librit të Tij!

Sikurse thotë edhe Imam Maverdi, në tefsirin e tij të ajetit të lartpërmendur: "Kur'ani është përkujtesë për ty dhe për popullin tënd"⁹: "përfshin edhe të gjithë ata që të pasojnë ty (o Muhammed) nga ymeti yt"¹⁰ Pra, këtë kujtesë dhe nderim hyjnor, duhet ta kemi për nder ta kemi të gjithë ne, busull orientimi dhe pishtar që ndriçon,

8. Dr. Sheuki Ebu Khalil, "Men dajjaal-Kur'an", botimi i tretë, Damask, 1986, f. 96.

9. Kur'ani, Ez-Zuhruf: 44.

10. Imam Ebu Abdull-llah Muhammed ibn Ahmed El-Ensari El-Kurtubi, vep. e cit., vëll. i 16-të, f. 92.

*UNË FTOJ TË RINJTË
MUSLIMANË, TA MENDOJNË
ME SHUMË SERIOZITET IDENË
E KTHIMIT TË KUR'ANIT
NË BURIM UDHËZIMI DHE
GURRË BEKIMESH HYJNORE,
QË E NDIHMOJNË PËR TA
JETUAR JETËNNË MËNYRË
SHEMBULLORE, DUKE
KËRKUAR FITIMIN
E PËLQIMIT HYJNOR!*

me lejen e Zotit!

Në përfundim, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj një konkluzion shumë të rëndësishëm, të cilin e bën H. Ali Korça në shkrimin e tij të cituar më lart: "Për librat e shenjta të tjera a gjinden pesë a gjashtë hafiza a jo? Por, për Hazreti Kuranin gjinden dhe do të gjinden me miliona Hafiza!

A nuk po na thotë sheshit se unë jam fjala e Zotit, jo fjala e Muhammedit, se po t'isha fjala e tij, pa dyshim do të kisha vdek edhe unë si gjuhët e tjera!"¹¹

(Hytbe e mbajtur

në xhaminë e Parrucës)

Shkodër, më 10 korrik 2015

11. H. ALI, "Muxhize e Hazreti Kuranit", revista "Zani i Naltë", nr. 3, vit' i II, Tiranë, 1925, f. 451-458.





Admir Plaku

Imam, xhamia "Ebu Bekr"

Ramazani muaji i identitetit erdhi dhe iku. Këtë vit u largua me një ndjenjë të veçantë shpirtërore, me shumë mësimë besimore dhe edukative, duke vijëzuar si përherë rrugën e drejtë, ku duhet të ecin besimtarët.

Namazi i sabahut, në ditën e parë të muajit Sheval, është i veçantë, sepse me vete mbart jehonën dhe atmosferën Ramazanit, që tashmë shkoi. Kjo jehonë vjen në këtë ditë, si një amanet që Ramazani u lë besimtarëve, për ta përcjellur frymën e tij, edhe në muajt e tjerë të vitit. Namazi i sabahut, në këtë ditë është i bashkëshoqëruar me frymën e fladeve të Ramazanit, mëson njeriun se si të jetojë si musliman, jo vetëm gjatë një muaji, por gjatë tërë jetës së tij.

Agjëruam për hir të Allahut (xh.sh) dhe inshallah agjërim të pranuar, pasi është vërtetë një sakrificë e madhe. Por, të jemi të vetëdijshëm se agjërimi nuk mbaron me muajin e Ramazanit, ai vazhdon edhe pas tij duke mbartur të njëjtën vlerë e shpërblim tek Allahu (xh.sh). Agjëruam një muaj të plotë dhe me mirësinë dhe mëshirën e Allahut (xh.sh) ndjemë kënaqësinë e të qenurit pranë Tij. Kuptuam mirësitë e shumta që na rrethojnë, mirësi të cilat kur nuk jemi agjërueshëm, as nuk i shikojmë e as nuk i kuptojmë. Andaj pastroje shpirtin tënd me një ditë agjërimi për hir të Allahut kurdoherë, sepse Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush agjëron një ditë për hir të Allahut (xh.sh) fytyra e tij i largohet xhehenemit për shtatëdhjetë vjeshta (vite).”¹ Në këtë muaj falëm një namaz synet të veantë e shumë domethënës, atë të teravisë, i cili na mësoi se kur kryejmë synetet përforcojmë farzet.

Ramazani ka një frymë të veantë, përcjell dhe kërkon unitet mes

1. Muttefekun alejhi

ÇFARË NA MËSOI MUAJI I RAMAZANIT?

besimtarëve. Ky muaj na tregoi se sa vlerë ka ruajtja e frymës së xhematit. Na mësoi se ajo ruhet edhe duke respektuar kohën e fillimit dhe të mbarimit të ibadetit, qoftë agjërim apo namaz.

Ashtu si namazi i teravisë, edhe shtrimi i iftareve është frymë specifike e Ramazanit, që na mësoi se sa rëndësi ka respektimi i lidhjeve familjare e shoqërore në jetën e besimtarit, gjatë Ramazanit, por edhe pas tij. Të shumta kanë qenë këtë vit iftaret e shtruara për agjërues e agjëruese. E tillë duhet të jetë jeta e besimtarëve që garojnë në bamirësi për hir të Allahut. Këto bamirësi që i evidentoi Ramazani janë një dritë shprese dhe ogur i mirë për shoqërinë tonë.

Shumë besimtarë e besimtare, falën namaz për hir të Allahut, sidomos në pjesën e tretë të natës, kur të tjerët flinin gjumë. S'ka dyshim se shpërblimi për ta është i premtuar! Në këtë kontekst Allahu (xh.sh) thotë: “Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se farë gëzimesh janë fshehur për ta (në jetën tjetër) si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”² Të jemi të vetëdijshëm se namazi i natës është i pëlqyer si gjatë Ramazanit, por edhe pas tij. Transmetohet se Pejgamberi (a.s) e këshilloi djalin e një sahabiu (r.a) duke i thënë: “O Abdullah! Mos u bëj si filani, i cili falej natën pastaj e la namazin e natës!”³

Falja e namazit të natës është traditë profetike, është vepra e vazhdueshme e njerëzve të mirë, është mundësi afrimi tek Allahu (xh.sh) dhe vepër që pastron dhe fshin gjynahet. Nga Xhabiri (r.a) transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Gjatë natës ekziston një çast dhe nëse njeriu kërkon në të ndonjë të mirë të dynjasë, a të ahiretit, ajo do t'i jepet. Ky çast është çdo natë!”⁴ Prandaj nëse ke një nevojë, dije padyshim se Allahu të përgjigjet si në Ramazan, edhe pas tij. Kjo varet nga lidhja që ke krijuar me Allahun, sa ke qenë i sinqertë në adhurimin tënd ndaj Tij, sepse sinqeriteti në vepra tregon vazhdimësi.

Gjatë Ramazanit u ndaluan nga

2. Kur'ani, Es-Sexhde: 16-17

3. Muttefekun alejhi.

4. Transmetuar nga Muslimi.

ushqimi gjatë ditës, por u lejuam natës. Ndërsa veprat e fjalët e këqija i kemi të ndaluara ditën edhe natën, si në Ramazan, edhe pas tij. Me të vërtetë është humbje e madhe për njeriun, kur ai nuk llogarit veten e fjalët, që dalin nga goja e tij.

Ramazani mbaroi, por dera e pendesës mbetet e hapur për besimtarin edhe në muajt e tjerë. Në çdo iftar ndjehej një kënaqësi e veçantë, kënaqësia e punës së kryer dhe e besimit! Se shpërblimi është i garantuar nga Allahu (xh.sh). E tillë duhet të jetë jeta e besimtarit; i angazhuar përherë duke punuar atë që beson se shpërblehet.

Gjatë një muaji jeta e çdo besimtari iu nënshtrua një disiplinë të veantë hyjnore. Një disiplinë, që harmonizonte jetën e besimtarit në kryerjen e obligimeve hyjnore dhe atyre shoqërore. Ramazani na mësoi se në jetën tonë nuk ka vend për neglizhencë, çdo pune mund t'i gjesh kohën për ta kryer. Ditët që do të pasojnë Ramazanin do të jenë një dëshmi e qartë sesa e kemi përjetuar agjërimin e shtimin e adhurimit në këtë muaj.

Ta jetosh jetën me frymën e Ramazanit do të thotë të mbash e të forcosh lidhjen me Allahun (xh.sh). Ta jetosh jetën me frymën e Ramazanit do të thotë të ruash identitetin e të qenurit besimtar. Ta jetosh jetën me frymën e Ramazanit do të thotë të ruash harmoninë në familje dhe shoqëri. Kjo është rruga e vijëzuar për besimtarin gjatë Ramazanit dhe pas tij.

Vazhdoni këtë rrugë të nisur në këtë muaj të madhërueshëm, mos i shkelni vijëzimet e kësaj rruge të diktuar nga fjala e Allahut, sepse përherë do t'ju ndjekë jehona e fjalës hyjnore “Nga po shkoni?”⁵. E cni në këtë rrugë dhe gjeni gëzimin e lumturinë e të dy jetëve!

E kërkuam mëshirën e Allahut gjatë Ramazanit. Allahu e ka shtrirë mëshirën e Tij edhe në muajt e tjerë të vitit, në kohë të ndryshme gjatë ditës dhe javës. Edhe pse Ramazani u largua, Krijuesi i tij e i gjithësisë qëndron pranë nesh mjafton që t'i drejtohem me lutje e të marrim përgjigjen që kërkojmë. “E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet”⁶.

5. Kur'ani, Et- Tekvir: 26

6. Kur'ani, El-Bekare: 186



Naim Drijaj

Imam, xhamia Parrucë

TË VAZHDOJMË NË PUNË TË MIRA

konsiderohet se ka agjëruar tërë vitin.”¹

Imam Neveviu ka thënë: “Dijetarët thonë: Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit është sikurse agjërimi i tërë vitit, sepse një e mirë shpërblehet me dhjetëfish kështu që Ramazani është i barabartë me dhjetë muaj dhe gjashtë ditët e Shevalit janë të barabarta me dy muaj.”

Allahu (xh.sh) thotë: “Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish...”²

Agjërimi i këtyre gjashtë ditëve pas Ramazanit është tregues i falënderimit të agjëruarit ndaj Zotit, për mundësinë që i është dhënë atij të agjërojë Ramazanin dhe të shtojë punët e mira.

Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit ka disa dobi:

1. Me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevalit plotësohet shpërblimi i agjërimin të një viti.

2. Agjërimi i muajit Shaban dhe Sheval konsiderohet si sunetet e rregullta para namazit të obliguar (farz) dhe pas tij. Me të plotësohen mangësitë dhe gabimet e ndodhura në farz, sepse farzet plotësohen me adhurimet vullnetare ditën e Gjykimit.

3. Përsëritja e agjërimin pas agjërimin të Ramazanit është shenjë e pranimit të agjërimin të Ramazanit, ngase Allahu (xh.sh) kur e pranon një vepër nga robi i Tij mundëson të bëjë një vepër të mirë pas saj. Sikurse që kanë thënë disa dijetarë: “Shpërblimi i së mirës është e mira që vijon pas saj.

4. Agjëruarit e Ramazanit i marrin shpërblimet e tyre ditën e Fitër Bajramit. Ajo është dita e ndarjes së shpërblimeve, prandaj agjërimi pas këtij muaji është falënderim për dhuntinë e faljes së gjynaheve, që nuk ka dhunti më të madhe se sa kjo.

A dëshironi të fitoni dashurinë e Allahut? Bëni çdo ditë një punë të

mirë. A e dini se ç’do të thotë të kryesh vazhdimisht një punë të mirë sado e vogël qoftë ajo? Do të thotë që ajo punë e mirë të bëhet shkak që të falen gjynahet tuaja. Njeriu nuk e di se cila nga punët e mira që ai do të veprojë do të bëhet shkak që Zoti ta fal atë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush thotë çdo ditë 100 herë SUBHANALLAHI VE BI HAMDIIHI, atij i falen gjynahet, edhe sikur të jenë sa shkuma e detit”. Por vini re! Pejgamberi (a.s) thotë: “Çdo ditë” dhe kjo nuk është e lehtë.

A e dini çdo të thotë ta vazhdosh punën e mirë e të mos e lësh pa kryer asnjëherë? Do të thotë të shpëtojë Zoti, kur ta ndiesh veten keq, atëherë kur je në një hall të madh. Kur Zoti e sprovoi profetin e Tij Junusin (a.s) duke e futur në barkun e balenës në thellësinë e oqeanëve, Junusi tha: “S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”³ Melekët thanë: “O Zot! Një zë i dobët që ne e njohim po vjen nga një vend i panjohur”. Zoti tha: “A nuk e dini se zëri i kujt është ai? Ky është zëri i Junusit. Ai po sprovohet në barkun e balenës” Atëherë melekët thanë: “O Zot, a nuk do ta shpëtosh robin Tënd që të ka përmend në ditë të mira dhe sot është në ditë të këqija?” Allahu (xh.sh) ua ktheu: “Po, do ta nxjerr. Pasha madhësinë Time, sikur ai të mos kishte qenë nga ata që më kujtonin Mua vazhdimisht, do të kishte qëndruar në barkun e asaj balene deri në ditën e Kiametit”.

Pra, Junusin (a.s) e nxori nga barku i balenës vetëm fakti, se ai e përmendte shumë Zotin çdo ditë.

Muslimanët nuk kanë vetëm një kohë të caktuar, si Ramazanin, apo një vend të caktuar, si haxhin, fjala vjen, për të bërë adhurim. Allahu (xh.sh) urdhëron e thotë: “Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të vijë vdekja.”⁴

E lusim Zotin (xh.sh) të na e bëjë ditën e sotme më të mirë se ditën e djeshme, ndërsa ditën e nesërme më të mirë sesa ditën e sotme.

1. Transmetuar nga Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.

2. Kur’ani, El-En’am: 160.

3. Kur’ani, El-Enbija: 87.

4. Kur’ani, El-Hixhr: 99.

Në barqet e nënave qëndruam 9 muaj pastaj dolëm pa gjynahe. Muaji i Ramazanit është muaji i nëntë sipas kalendarit hixhri, a thua vallë dolëm prej tij pa gjynahe?!

Mbaroi një muaj, gjatë të cilit trupi dhe shpirti i besimtarit gjeti prehje, sepse ai u lidh me krijuesin e gjithësisë. Gjetën prehje trupi, mendja, madje edhe stomaku. Një disiplinë e përkryer që lidhi trupat dhe shpirtat tanë me madhësinë e Allahut të madhëruar. Iku një muaj, që do ta kërkojmë shumë, sepse ai do të vijë përsëri vitin tjetër, por nuk e dimë nëse do të jemi gjallë deri atëherë apo jo.

Punët e mira të cilat besimtari i ka vepruar në Ramazan, duhet të vazhdojë t’i kryejë edhe pas Ramazanit. Vetëm kështu ai do të kuptojë se çfarë është muaji i Ramazanit. Përndryshe mund të themi se ai ishte vetëm një fllad, që fryu një kohë të shkurtër dhe më pas u fashit.

Ajo që sot duket e ardhme, nesër do të jetë e tashme, ndërsa pasnesër do të jetë e kaluar. Mos u mashtroni nga kjo jetë. Ramazani është argumenti më i fortë që na tregon se sa shpejt kalon koha.

Pa dyshim se Zoti i Ramazanit është edhe Zoti i muajve të tjerë. Përveç obligimit të agjërimin të muajit të Ramazanit, Allahu (xh.sh) i ka nxitur besimtarët që të kryejnë edhe agjërimin vullnetar të disa ditëve të caktuara në mënyrë që ata t’i afrohen sa më shumë Krijuesit të tyre.

Ebu Ejjub El-Ensari (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Ai që agjëron Ramazanin dhe agjëron edhe gjashtë ditë prej Shevalit do të



Shejkh Vehbi S. Gavoçi

DISA HADITHE QË JANË THËNË PËR TË

1. Hz. Osmani kërkoi leje për të hyrë te Profeti (a.s), që ishte mbështetur. Profeti (a.s) u çua, ndreqi rrobat, mandej lejoi të hynte Osmani. Hz. Aishe i tha: Hej i dërguari i Zotit (xh.sh), hyri Ebu Bekri, mandej Ymeri e i prite ashtu mbështetur siç qe. Kur deshi të hyjë Osmani u përgatite. Profeti (a.s) iu përgjigj: Po të mos përgatitesha e të qëndroja ndenjtur në takimin me të, do ta ndalonte turpi të shtronte kërkesën që mund të kishte.¹

2. Për luftën e parë të madhe me romakët Hz. Osmani ndihmoi me 1000 napolona ari, të cilët i derdhi para Profetit (a.s). Sahabiu, Abdurrahmani, djali i Eufit kallëzon: Vëreja Profetin se luante me ato para e thonte se “Çka të bëjë Osmani, të mos frikësohet, se Zoti (xh.sh) nuk e pyet për punët e veta.” Në një hadith tjetër thuhet se Hz. Osmani i dorëzoi Profetit (a.s) 300 deve për luftë, mandej shtoi edhe 300 të tjera, përsëri shtoi edhe 200 të tjera. Profeti (a.s) duke u ulur nga minberi tha: “Nuk e dëmton Osmanin tek Zoti (xh.sh) asnjë mëkat që mund të bëjë”.²

3. Profeti (a.s) ka thënë: “Çdo Profet ka shokë, shoku im në xhenet është Osmani”.³

EMRI I TIJ (JETËSHKRIMI)

Osmani ishte djali i Affanit, bashkohej fisi i tij me fisin e Profetit (a.s) në gjyshin Abdi Menafe, nëna e tij quhej Erva.

Ka lindur në Taif, 120 km larg Mekes në vitin 576. Ka pasur dy djem, të cilët

1. Transmetuar nga Muslimi.

2. Transmetuar nga Muslimi.

3. Transmetuar nga Tirmidhi.

OSMAN IBN AFFANI (R.A), KALIFI I TRETË (577-659)

i vdiqën, njëri në moshën 6 vjeç e tjetri në moshën 4 vjeç.

Pati si llagap Ebu Abdullah (Baba i Abdullahut) e më vonë një tjetër, Dhun-Nurejni (Zotërija i dy dritave), sepse pati për gra dy vajzat e Profetit (a.s), më parë Rukijen e, kur ajo i vdiq, mori Umme Kulthumen (r.a).

Ishte burrë i bukur, me trup mesatar, as i shkurtër, as i gjatë, me fytyrë tërheqëse, me lëkurë të butë, me ngjyrë gruri-esmer, mjekërmadh. Kur iu zmadhua, e ngjyente, rregullonte dhëmbët e prishur me ar.

Ishte i mençur, tregtar me famë, pasanik i njohur, i turpshëm. Ishte i butë me familjen e vet, nuk fyente as dënonte kënd në familje.

PËLQIMI I ISLAMIT

Ishte 30 vjeç, kur Ebu Bekri e thirri të hyjë në Islam. Ai pranoi shpejt, sa që qe i gjashti njeri që pëlqeu Islamin. Ebu Bekri i tha: Ti je i mençur, nuk gënjuhesh nga e pasakta, nga këto idhuj që i adhuron kombi yt. Ata janë të shurdhër që nuk dëgjojnë, ata janë qorra që nuk shohin.

Osmani u përgjigj: Unë betohem se ashtu janë.

Më vonë Ebu Bekri i tha: Këtu është Muhammedi, djali i Abdullahit, të cilin e ka dërguar Zoti (xh.sh) Profet për mbarë njerëzinë. A vjen tek ai e dëgjon çka thotë?

Po, po vi, u përgjigj Osmani.

Profeti (a.s) doli para tyre, e thirri Osmanin me emër dhe i tha: Përgjigju Zotit (xh.sh) që të thërret për në xhenet dhe dije, se unë jam Profeti për të gjithë njerëzit.

Pa vonesë, Osmani e pëlqeu fenë Islame duke pohuar “Lai-lahe il-lallah Muhammed resulu-llahi”. Mbas pak kohe mori për grua Rukijen, vajzën e Profetit (a.s).

Posa u përhap lajmi se Osmanit pëlqeu fenë e pastër e logjike, xhaxhai i tij (mbasi babai i kishte vdekur herët), ia lidhi duart dhe e burgosi në shtëpi duke i thënë: Do të jesh në burg, derisa të braktisësh këtë fe.

Këmbëngulja dhe qëndresa e fortë e

Hz. Osmanit në fe, e shtyri xhaxhain ta lëshojë nipin e vet burrë që të rronte, si të donte vetë.

Mbas tij pëlqeu fenë Islame motra e tij Amine, më vonë edhe vëllezërit nga nëna.

Disa besimtarë u detyruan të emigrojnë në Abisini, nga shkak i sjelljes së keqe e torturimit të disa njerëzve të mëdhenj në Medine. I pari prej tyre qe Hz. Osmani me Rukijen, gruan e vet, mandej i pasuan disa të tjerë. Hz. Rukije ishte grua besnike, e ndershme, pa fëmijë (përveç atij që vdiq i vogël). Vdiq nga sëmundja e lijës dy vjet mbas emigrimit, në Ramazan dhe u varros në Bakie.

“NUK E DËMTON
OSMANIN TEK ZOTI
(XH.SH) ASNJË MËKAT
QË MUND TË BËJË”.

Mbas një kohe, thuhet se mbas një viti, u martua me Ummi Kulthumen, vajzën e dytë të Profetit (a.s)

Saidi, djali i Musejjibit, tregon se, kur i vdiq Hz. Osmanit gruaja e parë dhe atë e ndeshi në rrugë të pikëlluar e të dëshpëruar, Profeti (a.s) e pyeti:

- Çka ke?

- Hej i dërguari i Zotit (xh.sh), a ka pësuar kush pikëllim sa unë? Më ka vdekur gruaja, vajza e Profetit (a.s), m’u këput dhëndëria me Profetin (a.s).

Siç ishin në këmbë në rrugë, kur shkëmbyen këto fjalë, erdhi Xhebraili e foli me atë Zotëri. Profeti (a.s) mandej i tha Osmanit: Më erdhi Xhebraili e më njoftoi: Të urdhëron Zoti (xh.sh) për të të dhënë Ummi Kulthumen me kurorë si të parën, me ato sjellje të mira.

Zotëri Osmani u gëzua pa masë për atë vendim.

Në Rebiul-evel të vitit të 3-të të

emigrimit u martua hz. Osmani me vajzën e dytë të Profetit (a.s), hz. Ummi Kelthume (r.a). Edhe gruaja e dytë nuk pati fëmijë, nuk jetoi shumë, vdiq në vitin e 9-të të emigrimit, d.m.th jetuan bashkë vetëm 6 vjet.

Kur shkoi hz. Osmani për vizitë të Profeti (a.s), mbasi i vdiq e shoqja, dëgjoi këto fjalë: “Po të kisha një vajzë të tretë, do ta kisha dhënë për grua, për shkak të mirësjelljes me familjen tënde”.

NË JETËN E PROFETIT (A.S)

1. Hz. Osmani qe një nga ata që regjistronin ajetet e Kur’anit, kur zbriteshin.

Erdhi një njeri te zonja Aishe e i tha asaj: Dikush e mallkon Osmanin. Ajo kundërshtoi: Zoti e mallkoftë atë që mallkon hz. Osmanin.

Kur i zbritën disa ajete të Kur’anit, Profeti (a.s), i tha Osmanit të shkruante: “Zoti nuk ia jep atë nder veç një të ndershmit”.⁴

Mori pjesë në luftëra të shumta me Profetin (a.s), rreth 27.

Profeti (a.s), kur rrinte ndenjor, shpeshherë vinte në krah të djathtë Ebu Bekrin, në të majtën Omerin, para vinte Osmanin, se e kishte sekretar, d.m.th. shkruante dokumente e letra të ndryshme, si e urdhëronte Profeti (a.s).

2. Në vitin e 6-të, Profeti (a.s) pau ëndërr se ai po hynte me disa sahabe në Mekë për Umre.⁵ Të nesërmen ua kallëzoi ëndrrën sahabeve.

Mbas pak ditësh Profeti (a.s) u përgatit për të shkuar në Mekë për Umre me 4500 sahabe, të cilët nuk morën armë, se qe udhëtim për adhurim e jo për tjetër gjë.

Ai karvan i bekuar doli nga Medineja në muajin e 11 -të (dhul-kaede) të vitit të 6-të, i prirë nga Profeti (a.s) me sahabet e mëdhenj: Hz. Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin, Alinë etj, e mori rrugën për në Mekë, derisa mbërritën në katundin Hudajbije. Aty u ndalën për të pushuar dhe për të lajmëruar sunduesit idhujtarë të Mekes, se kanë ardhur për adhurim e jo për luftë, mbasi Qabja është e të gjithë njerëzve, kushdo të jenë e ngado të vijnë.

Të parët e Mekes, posa dëgjuan për ardhjen e Profetit (a.s) me shokë,

4. Transmetuar nga Imam Ahmedi.

5. Umre, d.m.th. të vizitosh Meken, të sillësh rreth Qabes, të bësh Tavaf.

“HEJ ZOT, UNË JAM I KËNAQUR NGA OSMANI!”

u mblodhën për t’u këshilluar çka do të bënin. Pleqtë thanë se Qabja është për të gjithë njerëzit, secili që do ta vizitojë, e viziton e ne jemi shërbëtorët e saj e mburremi për këtë shërbim. Tjetër qëndrim mbajtën të rinjtë. Ata kundërshtuan, thanë se kurrë nuk do t’i lejojnë të hyjnë, sado që dëshirojnë arabët, sepse po t’i lëmë, ata do të mendojnë se ne jemi të dobët e u frikësuam prej tyre.

Mbas një polemike të gjatë u vendos: Të kthehej Profeti (a.s) me shokë në Medine, pa hyrë në Mekë, por me premtimin se do të hyjnë në vitin e ardhshëm po në këtë datë. Ashtu ndodhi.

Profeti dërgoi hz. Osmanin delegat të veçantë për t’u kallëzuar njerëzve në Mekë, se ai me shokë nuk kanë ardhur për luftë, por për një adhurim që e kryen kush dëshiron.

Kur shkoi hz. Osmani në Mekë, u prit mirë nga të parët e vendit, bile i propozuan të sille rrotull Qabes i lirë.

Ai refuzoi duke thënë: Jo, jo nuk bëj tavaf para Profetit (a.s).

Hz. Osmani, në ditët që qëndroi në Mekë, u mundua të merrte leje për të hyrë aty Profeti (a.s) me shokë, por më kot. Në atë kohë u hap fjala se hz. Osmani u vra. Në atë moment Profeti (a.s) mblodhi të gjithë sahabet që i dhanë besën për të luftuar, derisa të shfarosen shkaktarët, nëse vërtetë ishte mbytur hz. Osmani.

Mbas pak hz. Osmani u kthye me shëndet të mirë. Nga këto ngjarje duket se sa e vlerësonin hz. Osmanin Profeti (a.s) e shokët e tjerë.

Siç dihet, vitin e ardhshëm Profeti (a.s) me sahabe e kryen vizitën në Mekë. Kjo vërtetë ëndërrën që ai pau para një viti.

3. Në luftën e parë të madhe kundër romakëve (në Tebuk), romakët mbytnë një delegat musliman dhe u përgatitën të sulmojnë muslimanët në vitin e 9-të të emigrimit.

Atëherë Profeti (a.s) urdhëroi për t’u

përgatitur për luftë kundër romakëve dhe për t’i sulmuar në tokën e tyre. Profeti (a.s) kërkoi gjithashtu që secili të jepte ndihmën e mundshme, mbasi rruga ishte e largët, rreth 700 km, e romakët ishin një armik me njerëz e armë të shumta.

Ebu Bekri solli gjithë pasurinë e vet për herën e tretë në jetën e tij, solli 4000 derhem. Profeti (a.s) e pyeti: Çka i ke lënë familjes? Ai u përgjigj: I kam lënë Zotin (xh.sh) dhe Profetin (a.s).

Ndihmuan edhe mjaft të tjerë, kurse hz. Osmani, si pasanik bujar e besimtar, jo vetëm dorëzoi 950 deve me materiale të ndryshme, me anë të të cilave rregullohej dhe plotësohej 1/3 e ushtrisë, por dha edhe 1000 lira ari.

Profeti derdhi arin në prehrin e vet e tha me gëzim: “Hej Zot, unë jam i kënaqur nga Osmani”. Zoti (xh.sh) i fal gjithçka mbas këtij gjesti të bukur. Profeti (a.s) bëri një vlerësim shumë të mirë për të gjithë ata që patën dhënë për atë luftë: “Ai që armatosi luftëtarët e asaj lufte (Tebuk), ai është në xhenet”.

4. Profeti (a.s) një ditë tha se kush do ta blejë pusin Rumej, që t’u japë mundësi njerëzve të përfitojnë ujë falas prej tij, do të bëjë një vepër të lavdërueshme bamirësie. Ky pus ishte në rrugë të karvanëve e udhëtarëve për në Siri. Pronari ishte një çifut, i cili ua shiste shtrenjtë ujin atyre që kishin nevojë për të. Hz. Osmani lakmoi për ta bërë atë bamirësi, erdhi te çifuti e i tha t’i shiste gjysmën e pusit, d.m.th. të shfrytëzohej një ditë nga njëri dhe një ditë nga tjetri. Çifuti pranoi duke kërkuar një çmim të lartë.

Kur e bleu Osmani gjysmën e pusit, deklaroi ditët e shfrytëzimit të pusit nga ana e tij dhe njerëzit janë të lirë të marrin falas ujë nga pusi sa të duan. Njerëzit vinin e merrnin ujë sa donin për dy ditë. Kështu, në ditët e çifutit rrallë kush shkante për të blerë ujë. Çifuti e kuptoi se humbi. Më vonë hz. Osmani i propozoi çifutit për t’i blerë edhe gjysmën tjetër. Ai pranoi shpejt, e shiti lirë dhe në këtë mënyrë ai pus u bë për të gjithë njerëzit, pinin vetë, merrnin ujë për përdorim familjar e për kafshë, sa të donin falas. Ai pus është edhe sot, por gati ka shterrë, mbasi interesi për të është i kufizuar dhe nevoja për të e paktë.

AKTIVITET RAMAZANIT



ETE GJATË

1436/2015



MIRËSITË E RAMAZANIT TROKASIN NË DYERT E “SHTËPISË SË FËMIJËS”

Paraditën e së martës, më 23 qershor 2015, Myftinia Shkodër, në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën e Kuvajtit, bëri të mundur shpërndarjen e një kontingjenti ndihmash ushqimore për “Shtëpinë e Fëmijëve”, Shkodër.

Këto ndihma janë pjesë e programit të ndihmës dhe solidaritetit me njerëzit në nevojë, institucionet e ndryshme dhe xhamitë e xhamive të Shkodrës, në atmosferën e Muajit Ramazan, që Myftinia Shkodër realizon për çdo vit, në bashkëpunim edhe me partnerë të ndryshëm.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë mirëbërësit, shoqatat, fondacionet dhe biznesmenët që e vlerësojnë këtë muaj të begatë, duke dhënë nga pasuria e tyre në dobi të



atyre që kanë nevojë.

Myftinia Shkodër fton bizneset e qytetit, besimtarët dhe qytetarët e thjeshtë, që ta shfaqin frymën e

Ramazanit dhe mirëbërjes, duke mos nënvleftësuar asnjë mirësi, sado e vogël që të jetë, sidomos gjatë ditëve të këtij muaji të begatë.

IFTARI NË SOFRËN BUJARE TË SHOQATËS “ISTANBUL”

Ditën e enjte, më 25 qershor 2015, stafi i Myftinisë Shkodër, imamët dhe këshilltarët e saj ishin të ftuar në sofrën e iftarit, organizuar nga Shoqata “Istanbul”, në ambientet e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, dega vajza.

Tashmë është bërë traditë shumë e bukur në netët e Muajit Ramazan, që besimtarët të mbledhen në sofrat të ndryshme, ku shpirti i vëllazërisë, bujarisë islame, lutjeve dhe urimeve, është përherë i pranishëm në harmoni me vetë shpirtin bujar të këtij muaj vlerash.

Edhe sofrat e kësaj nate ishte dëshmi e kësaj atmosfere, ku bisedat vëllazërore, lutjet dhe interesimi për njëri-tjetrin u bënë shoqërues të mirë në sofrën e këtij iftari.

Pas përshëndetjeve tradicionale me rastin e këtij iftari vëllazëror, drejtuesit e Myftinisë, Shoqatës “Istanbul” dhe Medresesë “Haxhi



Sheh Shamia”, këmbyen përshtypjet e këtyre ditëve të begata të agjërimit, me lutjet që All-llahu ta ketë pranuar agjërimin, adhurimet dhe veprat bamirëse, si dhe me dëshirën e mirë të plotësimit të këtij muaj me mbarësi e begati.

Në emër të Myftinisë Shkodër, Myftiu, Imam Muhamed Sytari, falënderoi kryetarin e Shoqatës “Istanbul”, z. Ridvan Seferaj, për ftesën dhe mikpritjen, duke i uruar atij mbarësi dhe një muaj plot përkushtim dhe mirësi.

IFTAR ME FËMIJËT E XHAMISË SË FSHATIT KUÇ

Ditën e xhuma, më 26 qershor 2015, Myftinia Shkodër shtroi një iftar për të rinjtë dhe fëmijët frekuentues të xhamisë së fshatit Kuç.

Pas faljes së namazit të akshamit, të pranishmit këmbyen lutjet për pranimin e ditës së agjërimit, në sofrat e shtruara në oborrin e xhamisë, në një atmosferë të këndshme besimi dhe vëllazërie të pastër islame.

I pranishëm në këtë iftar ishte edhe përgjegjësi i sektorit të rinisë në Myftininë e Shkodrës, teologu Ervil Kuçi, i cili mbajti edhe fjalën e rastit.

Gjatë saj, ai theksoi mirësinë e madhe të muajit Ramazan dhe vlerën e sofrave të tilla, ku besimtarët e shtresave dhe moshave të ndryshme mblidhen për të ndjerë bukurinë e shpirtit të fesë dhe prekjet begatuese të këtij muaji.

Njëkohësisht, vuri në dukje se



Myftinia Shkodër e sheh me shumë rëndësi afrimin e brezit të ri me xhaminë, si shenjë e ripërtëritjes së vlerave dhe mesazheve islame, pas një periudhe, kur agjërimi, namazi dhe adhurimet e lira ishin të ndaluara me ligj në vendin tonë.

Ai uroi agjëruesit e rinj për vullnetin e tyre dhe dëshminë e besimit dhe uroi që ky Ramazan të jetë sa më i begatë për të gjithë besimtarët, familjet e tyre dhe për mbarë komunitetin.

Fondacioni “Mirësia”, ndihma ushqimore për agjëruesit në nevojë

Ditën e martë, më 30 qershor 2015, Fondacioni “Mirësia”, në bashkëpunim me Myftininë Shkodër, mundësoi shpërndarjen e 100 pakove ushqimore për agjërues të xhamisë së lagjes Dudas dhe disa xhamive të tjera të Shkodrës.

Kjo bamirësi vjen si një kujtim i mirë nga donatori nga Kuvajti, i cili mundësoi ndërtimin e xhamisë së re në lagjen Dudas, inaugurimi i së cilës u realizua në prag të Ramazanit të sivjetshëm.

I pranishëm në këtë aktivitet bamirës ishte edhe drejtoi i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, që shprehu falënderimet e tij për donatorin e nderuar, z. Hejthem Abdull-llah, sidomos në këtë muaj ku shtohen bamirësitë dhe solidarizimi në mesin e muslimanëve. Ai falënderoi edhe bashkëpunimin me Myftininë Shkodër dhe shprehu dëshirën e



vazhdimësisë në vepra të hajrit.

Ndërkohë, teologu Ervil Kuçi, duke shprehur falënderimet e Myftinisë Shkodër për donatorin dhe Fondacionin “Mirësia”, vlerësoi frymën e bashkëpunimit të shoqatave

dhe fondacioneve të ndryshme islame me Myftininë Shkodër, sidomos në këtë muaj të begatë, me qëllim gjallërimin e Ramazanit me aktivitete të larmishme në dobi të komunitetit.

MALËSIA E MADHE, INAUGUROHET XHAMIA E RE NË GRUDË-FUSHË

Pasditën e së enjtes, më 2 korrik 2015, Myftinia e Malësisë së Madhe organizoi ceremoninë e inaugurimit të xhamisë së re në fshatin Grudë-Fushë.

Ceremonia u përshëndet nga Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, i cili shprehu gëzimin dhe emocionet e tij për këtë mirësi të madhe, që i shtohet Malësisë së Madhe, në këto ditë të begata të Muajit Ramazan; xhamia e re në Grudë-Fushë.

“Nuk e di se nga të filloj, për të rreshtuar mirësitë me të cilat jemi rrethuar në këtë ditë; mirësia e Ramazanit, apo mirësia e këtij tubimi vëllazëror dhe namazi me xhemat, apo xhamia e re, apo lutjet tona në këtë ditë të begatë? Kjo është mirësia e madhe e besimit dhe fesë islame, që na tubon dhe na mbush me dritë besimi, sidomos në ceremoni si kjo e sotmja, ku po inaugurojmë së bashku xhaminë e re në fshatin tuaj”, - tha ndër të tjera Myftiu i Malësisë së Madhe.

Përshëndeti edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, i cili shprehu vlerësimet e tij për këtë bashkëpunim të dobishëm të Myftinisë

së Malësisë së Madhe me Fondacionin “Mirësia”, që solli në dritë këtë xhami të re e të bukur.

Myftiu vlerësoi shembullin e bamirësve dhe donatorëve në rrugën e gjallërimit të Thirrjes Islame në vendin tonë, por jo vetëm, ku përmendi disa raste të spikatura gjatë këtyre viteve.

Ceremoninë e përshëndeti edhe drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja,

që falënderoi Zotin për këtë mirësi dhe bashkëpunimin e familjes Hasanaj, që dhuroi tokën e xhamisë së re dhe të familjes turke që kontribuoi për ndërtimin e xhamisë.

Ai theksoi se kjo ceremoni duhet të jetë dëshmi besimi dhe një besëlidhje e re me xhaminë, për ta mbajtur në jetë, nëpërmjet aktivitetit, mësimet, namazeve, adhurime e lutjeve.

Përshëndeti edhe përfaqësuesi



i Fondacionit turk IHH, që uroi të pranishmit me rastin e inaugurimit të xhamisë së re.

Me rastin e kësaj ceremonie, Myftinia e Malësisë së Madhe shpërndau disa “Çertifikata Mirënjohjeje” për donatorët dhe Fondacionin “Mirësia”.

Pas kësaj ceremonie, u fala namazi i parë i iqindisë me xhemat dhe u bë lutja e këtij tubimi plot vlera besimi.

NJË IFTAR I VEÇANTË NË XHAMINË E PLUMBIT...

Ditën e dielë, më 5 korrik 2015, Myftinia Shkodër organizoi një iftar me frekuentuesit e rregullt të xhamisë së Plumbit, në një prej ambienteve të kësaj xhamie shekullore.

I pranishëm në këtë iftar ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili në përshëndetjen e tij, uroi të pranishmit për mirësitë e Ramazanit dhe theksoi se ky iftar është simbolikë e begatë të Ramazanit dhe vlerave të vëllazërisë dhe harmonisë islame në mesin e besimtarëve.

Ndërkohë, imami i kësaj xhamie dhe kujdestari i saj, H. Mithat Myftija, shprehu kënaqësinë e tij për realizimin e këtij iftari, si një risi e bukur në këtë muaj dhe si një motiv më shumë që e mban xhematin të lidhur si një familje e madhe besimi.



Të pranishëm në këtë iftar ishin edhe imamët, Lavdrim Hamja dhe Naim Drijaj, që u lutën për begatinë e këtij muaji dhe harmoninë në mesin e besimtarëve.

Pas namazit të akshamit me xhemat,

të pranishmit këmbyen urimet dhe përshëndetjet e tyre të përzemërta, duke shprehur kënaqësinë e tyre për këtë tubim të veçantë në këtë natë Ramazani.

HAP DYERT XHAMIA E RE NË FSHATIN KOPLIK I SIPËRM

Paraditën e së martës, më 7 korrik 2015, Myftinia e Malësisë së Madhe në bashkëpunim me Fondacionin “Mirësia”, organizoi ceremoninë e inaugurimit të xhamisë së re në fshatin Koplík i Sipërm.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte dhe përfaqësuesi i donatorit, z. Nebil Muhammedi nga Bahrejni, i cili është kthyer në një ambasador vlerash dhe bamirësie, duke afruar donacione bamirëse, sidomos për ndërtimin e xhamive të reja dhe qendrave kulturore, në qytete të ndryshme të Shqipërisë.

Pas prerjes së shiritit të inaugurimit, ceremonia u përshëndet nga H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe, Imam Muhamed Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, z. Nebil Muhammedi, përfaqësues i donatorit nga Bahrejni, z. Tahir Zeneli, kryetar i Shoqatës “Ardhmëria”,

z. Korab Kaja, drejtor i Fondacionit “Mirësia”, si dhe z. Begator Fikaj, imam i xhamisë Koplík i Sipërm.

Në fjalët e tyre, folësit, uruan të pranishmit për xhaminë e re, sikurse vlerësuan bashkëpunimin e muslimanëve në mbarë botën, si pjestarë të një familjeje të madhe besimi dhe vlerash.

U vlerësua kontributi i vëllezërve nga Bahrejni dhe dëshira e mirë për ta vazhduar këtë bashkëpunim edhe me ndërtimin e xhamive të reja, aty ku ka nevojë, si shtëpi adhurimi, ku brezat edukohen me moralin islam dhe vlerat e tij.

Me rastin e kësaj ceremonie, Myftinia e Malësisë së Madhe i akordoi z. Nebil Muhammedi një “Mirënjohje”, në shenjë vlerësimi



për kontributin e tij në drejtim të ngritjes së këtij objekti me vlerë.

Të pranishmit falën edhe namazin e parë të mesditës me xhemat në xhaminë e re të Koplíkut të Sipërm.

NJË IFTAR NDRYSHE NË XHAMINË E OBLIKËS...

Ditën e martë, më 7 korrik 2015, Myftinia Shkodër organizoi një iftar me xhematin e të rinjve të xhamisë së fshatit Oblikë. Në një atmosferë shumë të këndshme, sofrat e shtruara në oborrin e xhamisë, i jepnin asaj një pamje krejt ndryshe, të mbushur me mirësitë e këtij muaj të begatë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, vlerësoi angazhimin e të rinjve për ta gjallëruar xhaminë e tyre, duke falënderuar njëkohësisht edhe imamin e xhamisë, Ridvan Luzaku, për gjetjen e tij në krah të rinisë së kësaj xhamie.

Myftiu tha se Ramazani na krijon përherë mundësi për të dëshmuar bashkërisht frymën e vëllazërisë dhe harmonisë islame, edhe nëpërmjet këtyre sofrave bujare, ku nuk ka vlerë ushqimi as pija, sesa buzëqeshjet në fytyrat e njerëzve, bisedat e ngrohta



dhe urimet e singërta.

Njëkohësisht, tha se ky iftar është mundësuar falë bashkëpunimit me shoqatën bamirëse “Muslims for Humanity”, në New York të ShBA. Me këtë rast falënderoi

edhe koordinatoren e këtij donacioni, teologun Arben Halluni.

Në përfundim të këtij iftari, të pranishmit falën edhe namazin e akshamit me xhemat, duke u bërë dëshmitar të një dite plot begati.

TRIBUNA FETARE: “RAMAZANI, RIPËRTËRITJE E BESIMIT”

Pasditën e së mërkurës, më 8 korrik 2015, Myftinia Shkodër organizoi tribunën fetare me temë: “Ramazani, ripërtëritje e besimit”, ku i ftuar special ishte thirrësi islam Tahir Zeneli.

Në fillim të aktivitetit, teologu Arben Halluni, tha se dhjetë ditët e fundit të Ramazanit janë një mundësi e mirë për të shtuar aktivitetet dhe adhurimet, në mënyrë që ky muaj të dëshmohet si gjallërues i shpirttrave me besim dhe lutje.

Më pas, në përshëndetjen e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, falënderoi të pranishmit e shumtë për pjesëmarrjen në këtë aktivitet të dobishëm. Ai theksoi se këto ditë kemi dëshmuar mirësi pafund, që na lidhin dhe na afrojnë edhe më shumë me vlerat e Ramazanit, si: namazet me xhemat, leximi i Kur’anit, sofrat bujare të vëllazërisë islame, lutjet dhe adhurimet, bamirësitë etj.

Në fjalën e tij, Myftiu falënderoi edhe të ftuarin special të këtij tubimi, thirrësin islam Tahir Zeneli, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës “Ardhmëria”.

Një përshëndetje e përzemërt erdhi edhe nga z. Gëzim Danjollli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, që uroi të



pranishmit për muajin e agjërimit dhe mirësinë e madhe të bashkëpunimit në mes vete.

Me shumë kënaqësi, të pranishmit dëgjuan ligjëratën plot vlere dhe dobi të thirrësit islam Tahir Zeneli, në të cilën bashkëbisedoi me të ftuarit dhe të rinjtë e shumtë rreth krenarisë së besimit dhe vlerave të agjërimit në ringjalljen dhe ripërtëritjen e besimit në jetën e njerëzve.

Gjatë fjalës së tij, z. Zeneli theksoi se muslimanët janë të ftuar ta jetojnë jetën me besim dhe mrekullitë e tij, për t’i dhënë kuptim të sotmes dhe të ardhmes. Ai tërhoqi vëmendjen e dëgjuesve se Islami është edukues

drejt pëlqimit të Zotit në jetë dhe nxitës që njeriu të jetojë në paqe, si ndërtues vlerash.

Duke folur për vlerat e agjërimit, ai tha se pikërisht ky muaj, vjen për të trazuar ujërat dhe për të ringjallur shpresën e besimit ndër njerëz. Ndalimi i njerëzve nga ushqimi, është një gjendje me Zotin, për hatrin e së Cilit, njeriu frenohet nga miradi, që mund t’i konsumojë jashtë këtij muaj.

Në përfundim të këtij aktiviteti, për të pranishmit dhe kalimtarët u shpërndanë dy botime të reja të Myftinisë Shkodër, mbi vlerën e agjërimit dhe dobitë e muajit Ramazan.

Ditën e mërkurë, më 8 korrik 2015, Myftinia Shkodër organizoi një iftar me përfaqësues të bashkësive islame të Prizrenit, Ulqinit dhe këshillin e Myftinisë Shkodër.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, vlerësoi shpirtin e bashkëpunimit në mesin e tri myftinive, si dhe u ndal në një prezantim të begative të Ramazanit të sivjetshëm në Shkodër.

Me këtë rast, Myftiu falënderoi imamët për angazhimin dhe shërbimet e tyre, që xhamitë të dëshmojnë këtë frymë të mrekullueshme besim, sidomos në netët e teravisë.

Në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, përshëndeti imami Gëzim Danjollli, ndërsa imami Besim Cura, uroi në emër të Këshillit të

SIMBOLIKA TË VËLLAZËRISË ISLAME DHE KOMBËTARE NË SOFRËN E NJË IFTARI



Bashkësisë Islame të Ulqinit.

Të pranishëm në këtë iftar ishin edhe imamë të tri myftinive, drejtues

të shoqatave islame në Shkodër dhe Tiranë, si dhe antarët e këshillit të Myftinisë Shkodër.

Ditën e enjte, më 9 korrik 2015, Myftinia Shkodër shtroi një iftar, ku të ftuar ishin gazetarë të mediave të ndryshme lokale të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe.

Në emër të Myftinisë Shkodër, fjalën përshëndetëse e mbajti teologu Arben Halluni, përgjegjës i arsimit dhe medias, i cili falënderoi të pranishmit për pranimin e ftesës dhe uroi mbarësi në punën e tyre plot përgjegjësi në përcjelljen e lajmit dhe cilësinë e tij.

Z. Halluni falënderoi bashkëpunimin e deritanishëm me mediat lokale të Shkodrës, duke theksuar se media ka një rol të madh në informimin e drejtë dhe në kohë të njerëzve, sidomos me

SOFRA E IFTARIT ME GAZETARË TË SHKODRËS



ato lajme që ngjallin optimizëm dhe rrezatojnë mirësi e qytetari.

Ai tha se ky iftar është njëkohësisht

edhe një sofër mirënjohjeje dhe respekti në drejtim të krejt mediave lokale dhe atyre kombëtare, si simbole të fjalës së lirë e të përgjegjshme.

SOFRA BUJARE E RAMAZANIT NË XHAMINË E FSHATIT MES-MYSELIM

Ditën e shtunë, më 11 korrik 2015, sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, ka organizuar një iftar me fëmijë të përzgjedhur nga kursi i mësim-besimit në xhaminë e fshatit Mes-Myselim.

I pranishëm në këtë iftar ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili, në fjalën e mbajtur para kohës së iftarit, u lut që fëmijët e pranishëm të rriten me besim dhe me vullnetin e përparimit në dije, në edukatë, në moral, në komunikim me tjetrin, si muslimanë ndërtues.

Ndërkohë, teologu Arben Halluni, në fjalën e tij tha se ky iftar është simbol i frymës së familjes së madhe islame, në sofrën e së cilës, të gjithë janë të barabartë dhe pjestarë të nderuar. Ai tha



se ky iftar është edhe shenjë e vlerësimit të Muajit Ramazan dhe vetë xhamisë, ku është organizuar kjo sofër bujare.

U falënderua edhe bashkëpunimi me sponsorin e këtij iftari, shoqatën

bamirëse "Muslims for Humanity", në New York të SHBA.

Një lutje me rastin e këtij iftari u bë edhe nga imami i xhamisë, teologu Altin Nikshiqi.

IFTARI NË OBORRIN E XHAMISË SË FUSHË ÇELËS...

Ditën e dielë, më 12 korrik 2015, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare Kulturore Shqiptare në Vjenë (Austri) - "Xhamia Imam El-Buhari", organizoi një iftar në oborrin e xhamisë "Ebu Bekër", në Fushë Çelë.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari falënderoi të pranishmit dhe shprehu emocionet e tij për këtë tubim, në të cilin ishin mbledhur pjesëmarrësit e rregullt në aktivitetin e Hatmes Sherife, leximit të plotë të Kur'anit, që edhe sivjet u organizua në xhaminë e Parrucës.

Myftiu u lut edhe për fëmijët e pranishëm, një pjesë e mirë e të cilëve kanë prezantuar ditë për ditë në leximin e Kur'anit.



Njëkohësisht falënderoi edhe koordinatoren e projektit të këtij iftar, z. Sidrit Kurtabegu, duke shprehur mirënjohjen e Myftinisë Shkodër për

këtë mirësi në komunitet.

Pas iftarit, të pranishmit falën së bashku namazin e akshamit dhe u lutën për pranimin e kësaj dite plot begati.

Në një atmosferë të mrekullueshme besimi, ditën e hënë, më 13 korrik 2015, pas namazit të iqindisë, në xhaminë e Parrucës, u zhvillua ceremonia e Hatmes Sherife.

Nga dita e parë e agjërimit e deri më sot, nën drejtimin e Myftiut të Shkodrës dhe me praninë e disa imamëve, u lexua plotësisht Kur'anin Famëlartë, duke realizuar në këtë mënyrë një mirësi të madhe, që ka vlerat e veta, sidomos në këtë Muaj.

Pas faljes së namazit të iqindisë, fjalën e rastit e mbajti teologu Arben Halluni, i cili uroi të pranishmit e shumtë me rastin e Natës së Kadrit. Ai tha se kjo natë finalizon mirësitë e panumërta të këtij Muaj, si një bekim nga Zoti për besimtarët.

Më pas, Imam Muhamed Sytari, në fjalën e mbajtur me rastin e këtij tubimi, theksoi se Kur'ani është një mirësi hyjnore, një garanci për ymmetin islam dhe një thirrje e pashtershme për mbarë njerëzimin. Ai u lut që Zoti, me mëshirën e Tij, ta bëjë Kur'anin pikëreferimi për muslimanët e mbarë botës, drejt ripërtëritjes dhe rikthimit të dinjitetit dhe krenaria legjitime e munguar prej rreth një shekulli.

Mbrëmjen e së martës, më 14 korrik 2015, z. Lorenc Luka, kryetar në detyrë i Bashkisë Shkodër, organizoi iftarin tradicional të Bashkisë Shkodër, në nder të muajit Ramazan.

Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Luka theksoi se ky iftar është shenjë respekti dhe nderimi për besimtarët muslimanë, që agjërojnë me përkushtim muajin Ramazan.

Njëkohësisht, përmendi momente të spikatura të drejtimit të tij të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Myftininë. Ai tha se për një drejtues të Bashkisë është shumë e rëndësishme të ketë frymën e bashkëpunimit me institucione, me të cilat bashkëpunon në dobi të projekteve të ndryshme sociale.

Në këtë iftar tradicional ishte i pranishëm edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, i cili vlerësoi këtë traditë të bukur, të nisur nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, në nder të muajit të agjërimit dhe besimtarëve agjërues.

Myftiu falënderoi kontributin e

CEREMONIA E HATMES SHERIFE MBUSH XHAMINË E PARRUCËS



Një ligjëratë me vlera shkencore mbi dobitë e Natës së Kadrit dhe shfrytëzimin e saj, e mbajti teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave".

Në ligjëratën e tij, hodhi dritë mbi komentet e shumta dhe të larmishme të sures "El-Kadr", si dhe sqaroi rëndësinë që ka shfrytëzimi i kësaj Nate me lutje e dhikër, me qëllim përfitimin e mëshirës dhe faljes hyjnore.

Më pas, imamët e nderuar, vijuan

plotësimin e Hatmes Sherife, me leximin e 20 sureve të fundit dhe duanë e gjatë në gjuhën shqipe, nga Myftiu i Shkodrës.

Në fund të ceremonisë së Hatmes Sherife, u shpërndanë me qindra kopje të përkthimit të kuptimeve të Kur'anit në gjuhën shqipe, mundësuar nga Shoqata Humanitare Kulturore Shqiptare në Vjenë (Austri) - "Xhamia Imam El-Buhari", në bashkëpunim me Myftininë Shkodër.

IFTARI TRADICIONAL I KRYETARIT TË BASHKISË SHKODËR



madh e të vlerësuar të z. Lorenc Luka, sidomos në bashkëpunimet e frutshme me Myftininë Shkodër.

Me rastin e këtij iftari, Myftiu i dhuroi z. Luka një kopje të përkthimit të kuptimeve të Kur'anit në gjuhën shqipe, në shenjë respekti për këtë

traditë të bukur të Bashkisë Shkodër dhe vetë z. Lorenc Luka.

Myftiu theksoi, se përtej faktit të përfundimit të mandatit të kryebashkiakut të Shkodrës, z. Lorenc Luka do të mbetet mik i shtrenjtë dhe i mirë.

Pasditën e së mërkurës, më 15 korrik 2015, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me AIITC (Aiiic - Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam), organizuan një aktivitet shkencoro-kulturor në xhaminë e “Dy Vajzave”.

Me rastin e kësaj dite të begatë të Ramazanit, AIITC kishte sjellë ekspozitën e mrekullive të Kur’anit, që tërhoqi vëmendjen e vizitorëve të interesuar për të mësuar më shumë rreth kësaj teme.

Në emër të AIITC, fjalën e rastit e mbajti z. Alban Kodra, i cili theksoi se kjo ekspozitë ka një vlerë të madhe, pasi pasqyron mrekullitë shkencore të Kur’anit, në një format shumë të lehtë e të përshtatshëm për t’u lexuar e vizituar

Ditën e xhuma, më 17 korrik 2015, në mbarë ymmetin islam u festua dita e parë e Fitër Bajramit, pas një muaji të begatë agjërimit, plot adhurime dhe lutje në kërkim të pëlqimit të Zotit të gjithësisë.

Në Shkodër, ceremonia kryesore e kësaj feste, u zhvillua në vakëfin e shenjtë, bri xhamisë “Ebu Bekër”, në sheshin e Fushë Çelës, ku u krye fillimisht falja e namazit të sabahut me xhemat, që u shoqërua me një program të ndërthurur me ligjërata, recitime dhe këshilla fetare.

Pas faljes së namazit të sabahut, të cilin e drejtoi teologu Idmir Plaku, imam i xhamisë “Ebu Bekër”, ceremonia nisi me leximin e një pjese kur’anore nga teologu Nadi Braqi, imam i xhamisë Dudas.

Më pas, ligjëruan imamët e nderuar, Idmir Plaku, Naim Drijaj dhe Lavdrim Hamja, të cilët trajtuan tema që lidhen me atmosferën shpirtërore pas Muajit Ramazan, domosdoshmërinë e shfrytëzimit të festave islame për të ruajtur dhe konsoliduar lidhjet farefisnore, si dhe si duhet të jetë muslimani në raport me vërtetësitë e thelbit të fesë së tij.

Në ligjëratat e tyre të dobishme, imamët e nderuar dhanë këshilla të vyera për besimtarët, për të ruajtur frymën e Ramazanit, për të vazhduar në rrugën e përkushtimit dhe për të rritur cilësinë e marrëdhënies vëllazërore në mes vete.

U theksua njëkohësisht se prej vlerave të Ramazanit ishte edhe shtysa për t’u tubuar në rrethe të ngushta dhe të gjera, ku kryefjala e këtyre takimeve ishte përkushtimi dhe ruajtja e ekuilibrave

EKSPOZITA E MREKULLIVE TË KUR’ANIT, NË XHAMINË E “DY VAJZAVE”

nga të interesuarit.

Ndërkohë, imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja, falënderoi bashkëpunimin e Myftinisë Shkodër me AIITC, duke theksuar se aktiviteti i sotëm vjen si një kurorë e bukur, në fund të këtij muaji të mbushur me aktivitete të larmishme.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, i cili pasi falënderoi kontributin e AIITC në mbledhjen dhe përgatitjen e kësaj ekspozite të vlefshme, tha se prej kohësh shkencëtarët perëndimorë po

udhëzohen në Islam nëpërmjet studimit të këtyre mrekullive kur’anore. Ai përmendi dijetarin Krisi Morrison, i cili në një prej librave të tij të titulluar: “All-llahu shfaqet në kohën e shkencës”, flet pikërisht për fenomenin e udhëzimit në Islam të dijetarëve të shumtë, specialistë të fushave të ndryshme të shkencës.

Pas faljes së namazit të akshamit me xhemat, për të pranishmit u shtrua një iftar i mbështetur nga AIITC, si dhe u shpërndanë disa libra botime të Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam.

FITËR BAJRAMI, SHESHI I FUSHË ÇELËS, DËSHMITAR I LAVDISË SË BESIMIT

në jetë.

Me shumë emocion, të pranishmit dëgjuan pjesët poetike të interpretuara nga medresisti Enis Rexha, nga Ulqini, i cili i dha një shije të veçantë ceremonisë së këtij Bajrami.

Në orën 06.08, nën drejtimin e Myftiut të Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, u bë edhe falja e Fitër Bajramit. Pas saj, nën shoqërimin e tekbireve, Myftiu nisi të mbajë hytben e rastit, ku dha disa mesazhe të rëndësishme për besimtarët muslimanë të Shkodrës.

Në hytben e tij, Myftiu theksoi se Ramazani nuk ishte thjeshtë një stacion adhurimi, por një sistem jetese, që na merr për dore drejt një edukimi të mrekullueshëm, duke nisur me forcimin e bindjes së nuk ka Zot tjetër pos All-llahut, i Cili nuk ka as djalë as vajzë, as ka lindur prej kujt as ka lindur kush prej Tij, që nuk ia ka nevojën askujt dhe asgjëje dhe që çdo gjë, e njohur dhe e panjohur në këtë univers, është krijesë e Tij.

Myftiu tha se agjërimit na edukon me modestinë në jetë dhe shtrimin e rrugëve që shpjen drejt ruajtjes dhe konsolidimit të paqes sociale.

Ai tha se sot, përtej propagandave të stisura, ku ditë pas dite sulmohet Islami dhe muslimanët, besimtarët duhet të ndjehen përherë e më shumë krenarë me fenë e tyre islame, që është burim dijeje, qytetërimi, përkushtimi dhe humanizmi në këtë botë.

Myftiu iu referua edhe historisë sonë kombëtare, ku theksoi se shqiptarët duhet të ndjehen krenarë, sepse për mbi pesë shekuj kanë qenë drejtues dhe udhëheqës të njërit prej kalifateve më të spikatur të historisë islame, atij osman, ku shqiptarët kishin me dhjetra kryeministra e ministra, dijetarë e shkencëtarë, që i dhanë dritë e mirësi kësaj bote.

Për një moment, gjatë hytbes së Myftiut, në sfond nisën të dëgjoheshin këmbanat e Kishës Françeskane. Këtu, Myftiu e ndaloi hytben e tij duke thënë: “Prej vlerave të besimit tonë është edhe respekti ndaj tjetrit, edhe respekti ndaj këtyre këmbanave që bien, për një fë tjetër, që nuk është feja e jonë, mirëpo që i respektojmë dhe, po e ndaloj për pak çaste predikimin në respekt të vëllazërve tanë të krishterë dhe këmbanave të tyre”.

Myftiu ka bërë thirrje edhe për afrimin e mëtejshëm të muslimanëve shkodranë me Kur’anin Famëlartë, me leximin dhe kuptimin e tij dhe veshjen me moralin dhe shpirtin e tij të mrekullueshëm.


Në përfundim, Myftiu është lutur për të pranishmit, për Shkodrën, për Shqipërinë dhe mbarë ymmetin islam, që Zoti t’i begatojë e t’u dhurojë mëshirë, paqe e begati.

Dita e Fitër Bajramit ka shënuar një pjesëmarrje të madhe të besimtarëve të moshave të ndryshme, veçanërisht të rinisë shkodrane.



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË ORGANIZON

HAXHI 2015



Në paketën e Haxhit përfshihen:

- Transporti ajror vajtje-ardhje.
- Transporti me autobuz në Mekë dhe Medine.
- Akomodimi në hotele.
- Ushqimi, mëngjesi dhe darka (me përjashtim: Mina & Arafat).
- Kurbani, ihrami, ujë zemzemi, numra telefoni etj.
- Shoqërimi nga teologë dhe mjekë përgjatë ritualit.

- Pasaportë e vlefshme jo më pak se 1 vit. Për personat që nuk kanë nënshtetësi shqiptare, të jetë e shoqëruar me lejen e qëndrimit, e cila të jetë e vlefshme jo më pak se 6 muaj.
- Fotografi pasaporte (2 copë).
- Certifikatë që vërteton lidhjen e gjakut mes shoqëruesit dhe femrave që janë nën moshën 45 vjeçare.
- Vaksina kundër meningjtit, me afat jo më pak se 10 ditë dhe jo më shumë se tre vjet.

Të gjitha për vetëm
2800 Euro

Regjistrimet deri më 17 gusht 2015

Kontakto pranë Myftinisë Shkodër,
ose në numrat e mëposhtëm:

Tel. 02 224 20-81

Cel. 067 455 3880

Regjistrohuni pranë KMSH-së ose pranë myftinisë së qytetit tuaj deri më datë 17 gusht 2015

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja
Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org